



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 336/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Muhamet Rexha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Stranka Demokratski Promjena (SDP) me seli në Pejë, paraqitur kundër subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS) për shkak të manipulimit me qytetarë gjatë fushatës zgjedhore , në seancën e panelit të mbajtur me 10.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar.

ARSYETIMI

Më 6 Dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik SDP, ku pretendohet se subjekti politik NDS, ka shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, për shkak se NDS ka manipuluar qytetarët gjatë fushatës parazgjedhore, duke i bërë thirrje votuesve që të votojnë për koalicionin SDP-NDS. Sipas parashtruesit të ankesës kandidatët e NDS-se, Emilija Rexhepi dhe Safet Zoraniq, nëpërmjet një emisioni të RTK-se në gjuhën boshnjake datë 04.12.2010, kanë disinformuar publikun se SDP është në koalicion me NDS. Subjekti politik SPD thekson se ky koalicion nuk ekziston. Për më tepër SDP ka informuar KQZ-në me shkrim se organet dhe menaxhmenti i saj kryesor kanë vendosur të mos dalin në zgjedhjet e 12 Dhjetorit. Gjithashtu, sipas ankesës NDS ka vazhduar të mashtroj votuesit në Pejë duke vendosur pllakate të cilat pretendojnë ekzistencën e koalicionit SDP-NDS. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një pllakat me mbishkrimin SDP-NDS, kopjen e shkresave drejtuar KQZ në lidhje me mospjesëmarrjen në zgjedhjet e 12 Dhjetorit, si dhe listën e subjekteve politike të certifikuara për zgjedhjet e 12 Dhjetorit, të marre nga ueb faqja e KQZ-së

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

(c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

Prandaj duke e shqyrtuar dhe analizuar ankesën e subjektit politik SDP përfundojmë se ankesa në fjalë ka mungesë të provave për t'u bindur se nuk ka ndonjë dëshmi të qartë që do të mbështeste ankesën në fjalë, dhe dokumentet e ofruara si prova nuk japin fakte bindëse për shkeljen e pretenduar. Për me tepër pala ankuese thekson se rasti ka ndodhur nëpërmjet një emisioni të RTK-se, por nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar këtë fakt.

Për arsyet e lartcekura, PZAP-i konsideron që SDP nuk ka vepruar në pajtim me nenin 3.6 pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 336/2010 më datën 10.12.2010.

